

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E ENJTE 14 KORRIK 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot po flasim për një projektligj që ka të bëjë me krijimin e zonave të tëra zhvillimore, kërkimore dhe shkencore. Në fakt, i dëgjova me kujdes të gjithë kolegët, madje edhe kolegët e opozitës dhe po prisja nga opozita novatore ide të reja, por, për fat të keq, kanë po ato ide të vjetra. Kur flitet për inovacion, nuk kanë asnjë lloj ekspertize dhe ideje, po e njëjta gjë edhe kur flitet për ide dhe shkencë, sepse kanë shpirtin e kundërshtarit dhe pa ide. Gjithsesi, politikën që ka zgjedhur të bëjë opozita, gjithmonë kur flitet për inovacion, kërkim shkencor dhe për ide të reja politikën e bën duke kundërshtuar dhe duke mos dhënë asnjë lloj ideje.

Konkretisht, bëhet fjalë për ndërtimin e parqeve teknologjike shkencore, të cilat do të synojnë zhvillimin e industrive të teknologjisë së lartë dhe të inovacionit, mundësinë e krijimit të produkteve dhe të shërbimeve të reja, si dhe krijimin e vendeve të punës për profesionistët e shkencave teknologjike. Realisht, në kohën e digjitalizimit ku ne jetojmë sot, kjo gjë po zhvillohet edhe në Shqipëri me shpejtësi, ndaj më vjen shumë mirë që qeveria e ka marrë këtë nismë përmes këtij projektligji, duke krijuar lehtësira, duke u dhënë klimën e duhur investitorëve apo edhe personave fizikë, të cilët duan të aplikojnë për të ndërtuar parqe të tilla teknologjike dhe kërkimore.

Në fakt, dëgjova më parë që u tha 4 persona fizikë. Po, patjetër që ka persona fizikë, sepse ne kemi shumë të rinj nëpër botë që kanë dhënë ide, të cilët nuk janë institucionalizuar, por mund të kenë dhënë edhe ide dhe ua kanë shitur patentën e tyre edhe grupeve të mëdha të interesit,

patjetër edhe personave fizikë u lejohej që ta aplikojnë këtë gjë, kështu që detyra e shtetit është që t'i stimulojë dhe t'u qëndrojnë pranë këtyre të rinjve që kanë këto ide inovative.

Një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet zyrave të kërkimit shkencor dhe universiteteve do të sjellë një benefit edhe për shumë profesorë dhe akademikë që merren me shkencë, patjetër mund të ketë edhe studentë që kanë ide dhe që duan t'i implementojnë apo të bëhen bashkëpunëtorë në këto zyra, kështu që detyra jonë është t'i stimulojmë dhe t'u krijojmë lehtësira, siç janë ato fiskale dhe ligjore. Tendenca drejt këtyre parqeve teknologjike është në sinkron edhe me vendet e rajonit dhe vjen si rezultat i punës së qeverisë, e cila përmes këtij projektligji do t'u japë prioritet këtyre parqeve që ne të ecim me ritmin e duhur si vendet e tjera europiane. Patjetër, përmes kërkimeve shkencore dhe zyrave, në të cilat futen edhe parqet industriale, më vonë ne mund të kemi edhe patenta shqiptare, pra patenta Made in Albania!

Modele të suksesshme të parqeve teknologjike kanë të gjitha vendet më të zhvilluara, duke filluar që nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe vendet e zhvilluara të Europës. Kryesisht, modelet e tyre janë të fokusuar te vendet që shërbejnë si modele kërkimore shkencore, pak a shumë si korpuset universitare, vetëm se përveç kërkimeve shkencore-inovative në këto parqe përfshihet edhe krijimi i aktiviteteve të reja, të cilat mund të promovohen dhe të gjejnë vend në treg. Po ju përmend Italinë fqinje, e cila e ka filluar jo shumë herët ndërtimin e këtyre parqeve dhe sot numëron rreth 30 të tilla. Këto parqe teknologjike ndahen në tri modele të përqendruara në hapësira territoriale që shërbejnë për kërkime shkencore, në hapësira industriale me karakter të fortë teknologjik, iniciativa afër parqeve shkencore dhe sipërmarrjeve inovative.

Po ashtu, edhe shumë vende të tjera të Europës kanë modele të ndryshme të këtyre parqeve teknologjike. Duhet të kemi parasysh që inovacioni është nxitësi kryesor për zhvillimin ekonomik, ndaj i gjithë ky projekt madhor ka një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Duke u nisur nga ajo që ju përmenda më lart, si dhe nga eksperiencat e vendeve më të zhvilluara, ndërtimi i parqeve teknologjike na ofron mundësi për hapësira dhe për më shumë mirëqenie e zhvillim. Vetë kalimi

në një ekonomi digjitale kërkon edhe zhvillimin e ekosistemit të inovacionit, infrastrukturës ligjore, politikave të qarta fiskale dhe të sistemit efikas arsimor.

Parqet teknologjike nuk shihen vetëm si hapësira për inovacion, por edhe si një qendra jetike për kërkimin dhe edukimin, një qendër e zhvillimit tërësor jo vetëm ekonomik, por edhe në nivel burimesh njerëzore, si dhe një suport investimesh të reja. Përmes ndërtimit të parqeve teknologjike do të kemi në tërësi një numër të madh përfitimesh, të cilat do të çojnë në rritjen e mirëqenies dhe të përmirësimit të jetesës në përgjithësi. Më parë ekonomia bazohej mbi parimin sa më shumë konsumon dhe përdor burimin, aq më pak do të ketë për të ardhmen, ndërsa sot ekonomia i qaset parimit, sa më shumë konsumon burimet primare të dijes, aq më shumë prodhohet.

Nëpërmjet parqeve teknologjike synohet pikërisht të shndërrojmë inovacionin në impakt të drejtpërdrejtë në shoqëri. Ne sot jemi pikërisht në këtë moment, sepse i kemi të gjitha mundësitë dhe kapacitetet burimore njerëzore, duhet të jemi krenarë që i kemi këto burime si brenda vendit edhe jashtë, të cilët na nderojnë duke punuar në zyra kërkimore, shkencore dhe parqe teknologjike nëpër botë, atëherë përse mos t'ua krijojmë atyre mundësinë që këtë kontribut të vijnë dhe ta japin në vendin e tyre. Ky projektligj na ofron shumë, sepse nuk i ka benefitet vetëm në një drejtim, ndaj i ftoj të gjithë kolegët e maxhorancës dhe të opozitës që ta votojnë këtë ligj. Faleminderit!